

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Subvencionohen librat e rinj, të vjetrit vazhdojnë të shiten- A mund të ripërdoren ato?
ADRESA	https://indeksonline.net/subvencionohen-librat-e-rinj-te-vjetrit-vazhdojne-te-shiten-a-mund-te-riperdoren-ato-2/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 15:07:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 15:00:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	24bf40c7e2950b34f0140eca4508d37117939597aeecba4324fc2762e1941309
TEKSTI	368b67b6abacdf0f7f26091662e3382bf99efa8f2e6338d6628368969b2543d9
PAMJA	e08429f460d18a376b95c95be97f533a3ae9c694290c0b52aeda6b084d74ec2d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e4ffaaa7b5c8eacdebdbab95bb96d38f8f8c39da471b3d692eb76b0b87254770
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c73b9db3b820e04b50f750a03f22fa10ff4921dd00c9878ab3e6c4922c61ec25
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e4ffaaa7b5c8eacdebdbab95bb96d38f8f8c39da471b3d692eb76b0b87254770>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)

Kërko...


 Kërko produktin...  

SHPËRNDAJE



17:00 / E Diele, 06 Shtator 2026 / F.R

Subvencionohen librat e rinj, të vjetrit vazhdojnë të shiten- A mund të ripërdoren ato?



Pavarësisht subvencionimit të teksteve shkollore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, librat e përdorur të nxënësve të gjeneratës së kaluar vazhdojnë të shiten në faqe të ndryshme në rrjetet sociale.

Në njoftimet e publikuara nga prindër të ndryshëm, librat për nxënësit e klasave të para deri në të nëntat po ofrohen me çmime që variojnë nga 20 deri në 60 euro, varësisht nga cilës klasë i përkasin ato libra apo cila është gjendja e teksteve shkollore.

E nuk janë të pakta as komentet e prindërve që shprehin interesim për blerjen e tyre.

Kjo praktikë po vazhdon edhe pasi MASH-i njoftoi ditë më parë për ekzekutimin e subvencioneve për blerjen e teksteve shkollore për nxënësit e klasave 1 deri në 9.

Eksperti i arsimit, Rinor Qehaja, thotë se shitja dhe shkëmbimi i librave të përdorur është një problem që është shfaqur që nga fillimi i skemës së subvencionimit të drejtpërdrejtë për prindërit.

“Tash në momentin kur i bart mjetet drejtpërdrejt tek prindërit, atëherë padyshim që nuk ka ndonjë garanci që ato mjete gjithëherë përdoren për destinimin e blerjes së teksteve shkollore. Kjo është një problematikë jo vetëm sivjet, po që kur ka filluar ky subvencionimi i drejtpërdrejtë tek tek prindërit. Pra është një problem i në vete, po që pastaj është vështirë i kontrollueshëm se në fund të ditës nuk mundet askush me ia ndaluar askujt shkëmbimin e teksteve shkollore”, tha ai.

Sipas ekspertit, jo të gjitha tekstet janë të përshtatshme për ripërdorim, sidomos ato në të cilat nxënësit duhet të shkruajnë dhe të plotësojnë ushtrime.

“Disa tekste shkollore është e vështirë me i ripërdorur sepse për shembull matematika, kjo është e plotësuar. Është e vështirë me i kërkuar dikujt me i ruajtur, fshij për me i kthyer me i përdorur në vitin tjetër për një fëmijë tjetër. Sepse pastaj ky fëmija tjetër gjykojmë që është në padrejtësi ndaj tij. E përdor një tekst shkollor të përdorur, me gërvishje, gjëra të plotësuar. Kjo është ajo që na bën me kundërshtuar këtë rikthimin e teksteve shkollore sepse në fund të ditës vlerësoj që nëse sillet tregu i tekstit të ri shkollor nuk do të duhej të kishte ndonjë kosto të jashtëzakonshme që që nuk mund të mbulojë Qeveria”, tha ai.

Për këtë nga një shkollë fillore dhe e mesme e ulët në Prishtinë thonë se përdorimi i librave të gjeneratës së kaluar është problem për tekstet që duhet të plotësohen nga nxënësit ndërsa për të tjerat thonë se nuk paraqet problem të madh.

Drejtori i SHFMU “Pavarësia” në Prishtinë, Halil Braha thotë se ka raste kur prindërit mund t’i kenë blerë librat para se të ekzekutoheshin subvencionet, por edhe nga ata që i blejnë librat të përdorura për të kursyer para.

“Kjo mund të vlejë për nxënësit e nivelit fillor ku shumica e librave plotësohen domethënë me laps, edhe tani janë pothuajse të papërdorshme për gjeneratën e re. Ndërsa për nxënësit e klasave 6-të e tutje, librat domethënë nuk janë të plotësuar, mund të jenë vetëm ato fletore pune, po tekstet bazike nuk janë të plotësuar dhe hiq nuk ka gjë të keqe po që se përdoret edhe një libër që është i përdorur edhe nga nxënësit e dy viteve më parë... 03:58... Edhe nuk është e habitshme tek kjo ndodh dhe nuk më duket diçka e dëmshme, po që se e bëjnë prindërit. Me rëndësi është të pajisen, pavarësisht nëse ata e bëjnë këtë për të bërë ndonjë kursim të parave”, tha ai.

Krahas subvencionimit, MASH parasheh kthimin e teksteve shkollore në shkollat përkatëse dhe ruajtjen e tyre pas përfundimit të vitit mësimor.

Kjo dispozitë është e paraparë edhe me Udhëzimin Administrativ 02/2016, por sipas tij, zbatimi i saj ndër vite ka qenë i mangët.

Qehaja thotë se në momentin që mjetet financiare kalojnë te prindërit, institucionet nuk kanë kontroll të plotë se si shpenzohen ato.

“Mirëpo nuk gjykoj se është e drejtë me u kërkuar prindërve që shkojnë vetë i blejnë në librari i përdorin gjatë këtij viti me thënë ktheni pastaj në fund të ditës. Pra aktualisht në këtë format të subvencionimit të teksteve nuk më duket me të vërtetë e zbatueshme. Pra ka shumë përfshirje, do të duhej të kishte shumë përfshirje, shumë llogaridhënie në mënyrë që nesër çdo prind me i ruajtur tekstet shkollore edhe me i kthyer prapa, që në këtë kulturën që e njohim të në shkollat tona e të vetëdijes tek shumica e prindërve nuk do të thotë që do të mund të ndodhë aq lehtë”, tha ai.

Edhe drejtori i SHFMU “Pavarësia” thotë se që kur tekstet subvencionohen drejtpërdrejt të prindërit, ato më nuk kthehen në shkollë si më parë.

“Do duhet me u kthyer librat. Më herët është anlikuar që të kthehen librat mirëpo në këto vite që tani po subvencionohen nuk kthehen librat. Domethënë ata nxënësit edhe i sjellin në shkollë dhe dëica i

marrin edhe nga ato libra që i kanë kthyer gjeneratat e mëparshme. Mirëpo nuk kthehen librat. Mbase ato tani mund të bëhen edhe t'i ndajnë prindërit për vete dhe ose dikush tjetër edhe t'i shesë për gjeneratat e mëpastajme", tha ai.

Derisa librat e përdorur vazhdojnë të qarkullojnë në tregun online, mbetet e paqartë se sa prej tyre përfundojnë në duart e nxënësve të tjerë dhe sa prej subvencioneve të ndara për tekstet shkollore përdoren për blerjen e librave të rinj.

KosovaPress ka tentuar të marrë një qëndrim nga MASH sa i përket këtyre shitjeve ilegale të teksteve shkollore që po bëhen në faqe të ndryshme në internet por deri në publikimin e këtij artikulli nuk kemi marrë ndonjëpërgjigje./KP/

Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)



- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)



- [“I ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëbui nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i dehur gjybitet 2 herë, brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksidenti i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Lajme

- [00:05 / E Hënë, 07 Shtator](#)
[26-vjeçari plagoset me thikë në Tiranë](#)
- [23:25 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Një person me probleme shëndetësore u shkakton lëndime dy familjarëve, arrestohet nga policia](#)
- [23:13 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Tragjike në Rahovec: I mituri gjendet i plagosur me armë zjarri, mjekët konstatojnë vdekjen](#)
- [22:56 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Dyshohet se sulmuan kapitenin Besart Ahmeti, dy të dyshuarit janë djemtë e këtij polici](#)
- [22:28 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Gjendet pa shenja jete një person në Mitrovicë](#)
- [22:10 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: 20 vatra zjarri në vend, 11 mbeten aktive](#)



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.